



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Përdorimi i kartelave në Kosovë

T e t o r 2 0 1 8

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Përdorimi i kartelave në Kosovë

(bazuar në të dhënat e raportuara nga bankat komerciale)

**BOTUES** ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Sistemit të Pagesave  
33 Garibaldi, Prishtinë 10000  
Tel: ++381 38 222 055  
Fax: ++381 38 243 763

**FAQJA E INTERNETIT** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**ADRESA ELEKTRONIKE** [payment.systems@bqk-kos.org](mailto:payment.systems@bqk-kos.org)

**SHKURTESAT:**

ATM	Bankomat
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DSP	Departamenti i Sistemit të Pagesave
EFT-POS	Transferimi Elektronik i Mjeteve në Pikat e Shitjes
POS	Pikë e Shitjes

**INFORMATË:**

Për përshkrim më të detajuar referohuni shënimeve sqaruese.  
Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.  
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,  
Përdorimi i kartelave në Kosovë, Prishtinë 2018.  
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.  
Ky publikim përfshin të dhënat në dispozicion deri më 31 dhjetor 2017.

## Përmbajtja

<b>1.</b>	<b>HYRJE .....</b>	<b>6</b>
1.1	STRUKTURA E PUBLIKIMIT .....	6
1.2	KORNIZA LIGJORE .....	7
<b>2.</b>	<b>INFRASTRUKTURA E PAGESAVE .....</b>	<b>7</b>
2.1	TERMINALET ATM .....	7
2.2	TERMINALET POS.....	9
<b>3.</b>	<b>PËRDORIMI I KARTELAVE .....</b>	<b>10</b>
3.1	NUMRI I PËRGJITHSHËM I KARTELAVE .....	10
3.2	NUMRI I KARTELAVE SIPAS MOSHËS DHE GJINISË SË MBAJTËSIT TË KARTELËS .....	11
3.3	SA PËRDOREN DEBIT DHE KREDIT KARTELAT NGA KLIENTËT? .....	12
	3.3.1 Përdorimi i debit kartelave nga klientët.....	12
	3.3.2 Përdorimi i kredit kartelave nga klientët .....	14
3.4	PËRDORIMI I KARTELAVE PËR PAGESA ONLINE .....	17
<b>4.</b>	<b>TRANSAKSIONET ME KARTELA .....</b>	<b>18</b>
4.1	TRANSAKSIONET TË NDARA SIPAS VLERËS SE PAGESAVE .....	18
	4.1.1 Transaksionet me kartela në POS terminale.....	19
	4.1.2 Transaksionet me kartela në ATM terminale .....	19
	4.1.3 Transaksionet me kartela përmes internetit .....	20
<b>5.</b>	<b>TRANSAKSIONET ME KARTELAVE SIPAS VEND-NDODHJES SË TERMINALEVE TË PAGESAVE .....</b>	<b>21</b>
<b>6.</b>	<b>KONKLuzionET DHE TË GJETURAT E ANALIZËS .....</b>	<b>23</b>
<b>7.</b>	<b>LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE .....</b>	<b>24</b>

Të dhëna mbi numrin e terminaleve dhe kartelave bankare për vitin 2017 në Kosovë

<b>Banorë</b>		<b>1.79 milion</b>
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>		<b>10,887</b>
Densiteti (për km <sup>2</sup> )		164
<b>ATM</b>		<b>512</b>
	<i>për 1 milion banorë</i>	286
	<i>për 100 km<sup>2</sup></i>	5
<b>POS</b>		<b>11,501</b>
	<i>për 1 milion banorë</i>	6,425
	<i>për 100 km<sup>2</sup></i>	106
<b>Kredit Kartelat</b>		<b>164,740</b>
	<i>për 1 milion banorë</i>	92,034
<b>Debit Kartelat</b>		<b>926,209</b>
	<i>për 1 milion banorë</i>	517,435

## 1. Hyrje

Konkurrenca dhe eficiency në tregjet e shërbimeve financiare janë shumë të rëndësishme për çdo ekonomi, duke përfshirë edhe ekonominë e Republikës së Kosovës. Zhvillimet e shpejta në teknologji, modernizimi i sistemit të pagesave, shërbimet ndaj klientit dhe rritja e eficiency së sistemit bankar tashmë i kanë ofruar konsumatorëve mënyra të shumta të pagesave pa përdorur paranë e gatshme. Mënyrat e pagesës që konsumatorët po zgjedhin janë duke ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme.

Krahas masave për përmirësim të kornizës ligjore, rregullative si dhe zhvillimeve në infrastrukturë, BQK-ja i kushton një rëndësi të veçantë edhe përdorimit të instrumenteve të pagesave e cila llogaritet si një ndihmë e konsiderueshme në procesin e vendimmarrjes dhe reformave në fushën e sistemit të pagesave.

Kartela, transferi i kreditit, Kos Giro dhe Debitimi Direkt janë instrumente të pagesave jocabash me të cilat përdoruesit e këtyre shërbimeve transferojnë fonde mes llogarive në banka apo institucione të tjera financiare. Janë disa arsye kryesore që ndikojnë tek konsumatori për përdorim të këtyre instrumenteve siç mund të cekim: siguri më e madhe (nga vjedhja e parasë), transfere elektronike kudo, pagesa me kartelë kudo në botë dhe përmes internetit, më pak informalitet në ekonomi, etj.

Analiza e mëposhtme paraqet detaje të përdorimit të kartelës në Kosovë si dhe infrastrukturës së pagesave me kartelë.

Theksojmë se ky studim është i bazuar në të dhëna statistikore të bankave komerciale dhe përfshijnë periudhën Janar-Dhjetor 2017 dhe ka qëllim t'i sigurojë publikut një pasqyrë gjithëpërfshirëse të tregut të transaksioneve të pagesave të bazuara në kartelë në Kosovë në 2017, i cili duhet të jetë po aq i dobishëm për përdoruesit, për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe publikut të gjërë në përgjithësi.

### 1.1 Struktura e publikimit

Publikimi është i ndarë në shtatë kapituj. Kapitulli i parë është hyrja e publikimit, ku shpjegohet edhe struktura e publikimit si dhe një pasqyrë e shkurtër e kornizës ligjore sipas së cilës janë mbledhur të dhënat statistikore.

Kapitulli i dytë, me titull “Infrastruktura e pagesave” paraqet të dhëna rreth terminaleve të cilat janë në dispozicion për klientin.

Në kapitullin tre janë paraqitur detaje rreth përdorimit të kartelave në Kosovë. Kapitulli përmban të dhëna rreth numrit të kartelave, llojeve të tyre si dhe të dhëna rreth përdorimit të kartelave, të ndara edhe sipas gjinisë së mbajtësve të kartelave.

Në kapitullin në vijim, kapitulli katër, paraqet të dhëna rreth numrit dhe vlerës së transaksioneve të realizuara nga klientët gjatë vitit 2017. Të dhënat janë të ndara sipas terminaleve ku janë realizuar pagesat dhe gjithashtu sipas vlerës së pagesës.

Kapitulli i pestë tregon numrin dhe vlerën e transaksioneve me kartela sipas vendndodhjes së terminaleve, në qytetet kryesore të Kosovës.

Kapitulli i gjashtë është përfundimi i publikimit.

Kapitulli i fundit përmban listën e tabelave dhe figurave.

## 1.2 Korniza Ligjore

Njëra nga detyrat mbikëqyrëse të Bankës Qendrore të Kosovës është rregullimi dhe mbikëqyrja e instrumenteve të pagesave. Kjo detyrë është e definuar në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 22, pika 2.3 “*të rregullojë dhe të mbikëqyrë vënien në qarkullim dhe cilësinë e instrumenteve të pagesave*”.

Përcaktimi i kushteve, kërkesave dhe procedurave për lëshimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe përcaktimi i mënyrës së raportimit të informacionit gjatë përdorimit të këtyre instrumenteve të pagesave elektronike është i rregulluar sipas rregullores për instrumentet e pagesave elektronike. Gjithashtu, BQK ka të miratuar edhe rregulloren mbi raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave, e cila përcakton të dhënat statistikore që duhet të raportohen, raportuesit dhe obligimet statistikore të raportuesve, periudhën e raportimit dhe format e raportimit, konfidencialitetin, udhëzimet për hartimin e raporteve, si dhe standardet minimale të aplikuara për raportim.

## 2. Infrastruktura e Pagesave

Në tregun e Kosovës, në fund të vitit 2017 ishin 12,013 terminale në të cilat janë pranuar kartelat. Nga ky numër, 512 janë terminale ATM për tërheqje të parasë së gatshme si dhe 11,501 terminale POS për pagesa me kartelë.

### 2.1 Terminalet ATM

**ATM (automatic teller machine)** është pajisje elektromekanike që i lejon përdoruesit të autorizuar që duke përdorur kartela fizike të lexueshme nga pajisjet/makinëritë, të tërheqin para nga llogaritë e tyre apo/dhe qasje në shërbime, duke ju mundësuar p.sh. kontrollimin e gjendjes së llogarisë, transferimin apo depozitimin e mjeteve.



Në fund të vitit 2017 numri i terminaleve ATM ishte 512 terminale. Të gjitha терминаlet ATM që janë instaluar në Kosovë ofrojnë funksionin e tërheqjes, ndërsa 172 prej tyre ofrojnë edhe mundësinë e deponimit.

Tabela 1. Terminalet ATM


Terminalet sipas funksionit	2017
<b>Automated Teller Machines (ATM )</b>	<b>512</b>
prej të cilave:	
<i>ATM me funksion tërheqje cash</i>	512
<i>ATM me funksion të pagesave Kos-Giro</i>	109
<i>ATM me funksion depozitim cash</i>	172

Burimi: BQK (2018)

Në figurën 1 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve ATM në qytetet më të mëdha të Kosovës në fund të vitit 2017.

Nga grafiku konstatohet se pjesa më e madhe e terminaleve ATM është koncentruar në qytetin e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë mes qyteteve tjera të Kosovës. Arsyet e përqendrimit kaq të madh të terminaleve ATM në Prishtinë janë të ndryshme si: numri i madh i banorëve që jetojnë në Prishtinë, numri i filialeve të bankave, bizneset që operojnë në këtë qytet, etj.

Figura 1. Shpërndarja e terminaleve ATM nëpër qytete



Burimi: BQK (2018)

## 2.2 Terminalet POS

**Terminali POS** është një pajisje që lejon përdorimin e kartelave për pagesa në një pikë shitëse fizike (jo virtuale). Terminalet POS u mundësojnë klientëve kryerjen e pagesave me kartela pa pasur nevojë për para të gatshme. Kjo është një mënyrë shumë e lehtë dhe e sigurt e kryerjes së pagesave për mallra apo shërbime të ndryshme.

Tabela 2. Terminalet POS


Terminalet sipas funksionit	2017
<b>Terminale POS (Point of Sale)</b>	<b>11,501</b>
<i>prej të cilave:</i>	
<i>POS me funksion tërheqje cash</i>	165
<i>EFTPOS</i>	11,336

Burimi: BQK (2018)

Numri i terminaleve POS në fund të vitit 2017 ishte 11,501 terminale, nga te cilat 165 prej tyre ofrojnë edhe shërbimin e tërheqjeve cash.

Në figurën 2 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve POS në qytetet më të mëdha të Kosovës në fund të vitit 2017. Ngjashëm me shpërndarjen e terminaleve ATM edhe rrjeti i terminaleve POS është më i përqendruar në Prishtinë.

Figura 2. Shpërndarja e terminaleve POS nëpër qytete



Burimi: BQK (2018)

### 3. Përdorimi i kartelave

#### 3.1 Numri i përgjithshëm i kartelave

Në fund të vitit 2017 janë raportuar 1,090,949 kartela të klientëve në Republikën e Kosovës, të cilat përfshijnë kartela debiti dhe krediti për individë dhe biznese. Krahasuar me fundin e vitit 2016, numri i përgjithshëm i kartelave të klientëve është rritur për 7.7 përqind. Numri i përgjithshëm i kartelave në fund të vitit 2016 ka qenë 1,013,155 kartela. Për të njëjtën periudhë, debit kartelat janë rritur për 8.1 përqind ndërsa kredit kartelat për 5.3 përqind.

Tabela 3. Llojet e kartelave

Llojet e kartelave	Debiti	Kredit
<i>Kartela lokale</i>	19,301	965
<i>Visa</i>	670,135	133,168
<i>MasterCard</i>	236,773	30,607
<b><u>Numri i përgjithshëm</u></b>	<b>926,209</b>	<b>164,740</b>

Burimi: BQK (2018)

Kartelat që përdoren në Kosovë janë kartela lokale si dhe kartela të brendeve ndërkombëtare Visa dhe MasterCard. Nga numri i përgjithshëm i kartelave, 73 përqind e tyre janë të brendit MasterCard, 25 përqind janë Visa kartela si dhe afër 2 përqind kartela lokale.

Varësisht nga teknologjia që është aplikuar për inicimin e transaksioneve të pagesave, kartelat mund të ndahen në dy lloje: kartela contact dhe contactless.

Kartela ‘contact’ janë ato lloj të kartelave me të cilat realizohen transaksionet duke futur kartelën në POS terminal ndërsa kartelat contactless mundësojnë realizimin e transaksioneve vetëm duke ofruar kartelën afër POS terminalit, pra pa pasur nevojë për kontakt me paisje.

Kartela ‘contactless’ kanë filluar të lëshohen në Kosovë që nga viti 2016. Gjatë vitit 2017 ishin katër banka komerciale në Kosovë që kanë ofruar këto lloj kartela për klientët e tyre. Numri i përgjithshëm i kartelave contactless në fund të vitit 2017 ka qenë 131,736 kartela.

Nga numri i përgjithshëm i kartelave, 13 përqind e tyre ofrojnë mundësinë e pagesave contactless.

Tabela 4. Kartelat contactless

<b>Kartelat contactless</b>	<b>2017</b>
<b>Numri i përgjithshëm</b>	<b>131,736</b>
<i>prej te cilave:</i>	
<i>kartela debiti</i>	117,782
<i>kartela krediti</i>	13,954

Burimi: BQK (2018)


### 3.2 Numri i kartelave sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësit të kartelës

Nga të dhënat e prezantuara në Figurën 3 mund të themi se pjesa më e madhe e kartelave për të gjitha grup-moshat zotërohen nga meshkujt. Nga poseduesit e kartelave që i përkasin moshës 18-25 vjet, 57.9 përqind e tyre janë meshkuj, ndërsa 42.1 përqind e tyre janë femra.

Në grup-moshën 26-35 vjet, 66.1 përqind e kartelave posedohen nga meshkujt, ndërsa 33.9 përqind nga femrat. Për grup-moshat 36-45 vjet dhe 46-55 vjet, dallimi është akoma më i lartë: 71.7 përqind e kartelave zotërohen nga meshkujt ndërsa 28.3 përqind nga femrat, respektivisht 71.8 përqind nga meshkujt dhe 28.2 përqind nga femrat.

Pra, nga të dhënat e pasqyruara më lartë shihet se femrat kanë në zotërim numër më të vogël të kartelave krahasuar me meshkujt. Te qytetarët me moshë më të re ky dallim është më i vogël, por vije në dukje më shumë te qytetarët në moshë më të vjetër.

Figura 3. Numri i kartelave sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësit të kartelës



Burimi: BQK (2018)

### 3.3 Sa përdoren debit dhe kredit kartelat nga klientët?

#### 3.3.1 Përdorimi i debit kartelave nga klientët

Përdorimi i kartelave nga ana e klientëve është vazhdimisht në rritje. Disa banka në Kosovë kanë filluar edhe lëshimin e kartelave contactless, specifike e të cilave është përdorimi i tyre pa e shtypur fare PIN-in. Kryesisht kjo kartelë është e destinuar për pagesa me shuma të vogla dhe për numër të vogël të transaksioneve brenda një dite.


Gjatë analizimit të numrit të transaksioneve me kartela, rezulton se gjatë vitit 2017 grup-mosha prej 26-35 vjeç ka kryer numrin më të madh të transaksioneve me contact debit kartela, nga të cilët 60.2 përqind e transaksioneve janë kryer nga meshkujt ndërsa 39.8 përqind nga femrat. Gjithashtu edhe kartelat contactless janë përdorur me shumë nga kjo grup-moshë, ku 60.5 përqind janë kryer nga meshkujt kurse 39.5 janë kryer nga femrat. Kjo mund të nënkuptoj se kjo grup-moshë ka nivel më të lartë të njohurisë për përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe të ardhura më të rregullta mujore.

**Siguria** - Kartela bankare është instrument pagese dhe si e tillë duhet të ruhet dhe të përdoret me kujdes. Gjatë shfrytëzimit të saj duhet të jeni të kujdesshëm dhe të vëmendshëm


- Ajo mund të përdoret vetëm nga bartësi i saj – pra kartela duhet të ketë emrin tuaj.
- Duhet të keni kujdes me ruajtjen e numrit tuaj identifikues të kartelës (Personal Identification Number - PIN) (KUJDES: mos i mbani bashkë, kartelën dhe PIN-in, mos i tregoni PIN-in dikujt tjetër etj.)
- Informacionet mbi kartelën tuaj nuk duhet të jepen përmes telefonit, e-mailit, apo në formë tjetër të pasigurt.
- Në rast të humbjes së kartelës lajmëroni menjëherë bankën tuaj, e cila do të bllokojë kartelën menjëherë për të parandaluar keqpërdorimin e saj nga persona të paautorizuar.

Figura 4. Numri i pagesave me contact dhe contactless debit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).

*Contact debit kartela*



*Contactless debit kartela*




Burimi: BQK (2018)


Nga të dhënat në figurën 4, shihet se qytetarët e grup moshave 26-35 vjeç si dhe 36-45 vjeç kanë realizuar pagesa me vlerë më të madhe gjatë vitit 2017, krahasuar me grup moshat e tjera, si me kartela contact ashtu edhe me ato contactless. Nëse bëjmë ndërlidhjen mes numrit dhe vlerës së transaksioneve me debit kartela, mund të konstatohet se femrat dhe meshkujt realizojnë numër të përafërt të transaksioneve, mirëpo dallimi qëndron në vlerën e këtyre pagesave siç është paraqitur në figurën më poshtë. 76.3 përqind e vlerës së transaksioneve me contact debit kartela është realizuar nga meshkujt e grup-moshës 26-35 vjeç, ndërsa vetëm 23.6 përqind nga femrat.

Figura 5. Vlera e pagesave me contact dhe contactless debit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).

*Contact debit kartela*



*Contactless debit kartela*



Burimi: BQK (2018)

### 3.3.2 Përdorimi i kredit kartelave nga klientët

Kredit kartelat u mundësojnë mbajtësve të tyre të kryejnë pagesa apo edhe të tërheqin para të gatshme deri në një limit të paracaktuar nga lëshuesi i kartelës. Kredia e lejuar mund të kthehet si e tërë në fund të periudhës së paracaktuar apo të kthehet në pjesë, sipas marrëveshjes me bankën. Zakonisht, bankat aplikojnë interes ndaj mbajtësit të kartelës për shumën e kredisë së shfrytëzuar.


Kredit kartelat janë kthyer në mjet të përditshëm për qytetarët për kryerje të pagesave, si dhe për menaxhim të financave të tyre. Krahas rritjes së numrit të kredit kartelave, viteve të fundit shihet edhe një rritje e përdorimit të tyre për kryerje të pagesave si në terminale ATM dhe POS, ashtu edhe për blerje “online”.

Nga të dhënat e prezantuara në figurën 6, vërejmë se qytetarët e moshës 26-35 vjeç dhe ata të moshës 36-45 vjeç kryejnë numër më të madh të transaksioneve me contact kredit kartela dhe gjithashtu e njëjta vlen edhe për kartela contactless.

Nga numri i përgjithshëm i transaksioneve me contact kredit kartela shihet se 71.3 përqind e transaksioneve janë kryer nga meshkujt, ndërsa 28.7 përqind nga femrat.


Dallimi më i madh qëndron në numrin e transaksioneve të kryera nga qytetarët e moshës mbi 55 vjeç, ku shihet se 78.8 përqind e transaksioneve me contact kredit kartela kryhen nga meshkujt, ndërsa vetëm 22.2 përqind e tyre kryhen nga femrat.

Figura 6. Numri i pagesave me contact dhe contactless kredit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).





Contactless kredit kartela





Burimi: BQK (2018)

Në figurën 7 është paraqitur vlera e transaksioneve me contact dhe contactless kredit kartela të kryera gjatë vitit 2017 nga qytetarët e Kosovës. Nga të dhënat e prezantuara vërejmë se 77.6 përqind e vlerës së transaksioneve me contact kredit kartela është kryer nga meshkujt, ndërsa 22.4 përqind e tyre janë kryer nga femrat.

Figura 7. Vlera e pagesave me contact dhe contactless kredit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).

Contact kredit kartela






### 3.4 Përdorimi i kartelave për pagesa online

Krahas rritjes së numrit të përdoruesve të internetit në Kosovë, janë rritur edhe blerjet “online” (pagesat me kartela) përmes internetit. Pasqyrimi sipas faktorëve socio-demografik, konfirmon trendët e blerjeve online gjatë vitit 2017, nga shihet se klientët e moshës më të re janë më të familjarizuar me blerjet online.

Nga figura 8 vërehet se numrin më të madh të transaksioneve online e kanë realizuar meshkujt e grup-moshës 26-35 vjeç me 68.2 përqind të numrit të transaksioneve në krahasim me femrat e kësaj grup-moshe të cilat kanë kryer 31.8 përqind të transaksioneve.


Figura 8. Numri i pagesave online



Në figurën 9 është paraqitur vlera e blerjeve “online” me kartela. Nga të dhënat e prezantuara konstatohet se nga të gjitha grup-moshat, meshkujt janë ata të cilët bëjnë më shumë blerje “online”.

Vlera e transaksioneve “online” të kryera nga klientët e moshës 26-35 vjeç dhe ata të moshës 36-45 vjeç ka pjesëmarrjen më të madhe në vlerën e përgjithshme të blerjeve “online”. Në grup-moshën 26-35 vjeç 74 përqind e blerjeve “online” janë kryer nga ana e meshkujve ndërsa 26 përqind nga femrat. Dallimi gjinor më i madh është në grup-moshën +55 vjeç, ku nga vlera e përgjithshme e blerjeve “online” me kartela, 88 përqind e tyre është kryer nga meshkujt ndërsa vetëm 12 përqind e tyre nga femrat.

Figura 9. Vlera e pagesave online (me kartela përmes internetit)



Burimi: BQK (2018)

## 4. Transaksionet me kartela

### 4.1 Transaksionet të ndara sipas vlerës së pagesave

Në fund të vitit 2017 në Kosovë kanë qenë të instaluar 11,501<sup>1</sup> terminale POS të cilët u mundësojnë qytetarëve të kryejnë pagesa me kartela, pa pasur nevojë për të kryer pagesa me para të gatshme. Kjo është një mënyrë shumë e lehtë dhe e sigurt e kryerjes së pagesave për mallra apo shërbime të ndryshme.


<sup>1</sup> Analizë mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë, <https://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemiIPagesave/Analyze%20Remujore.pdf>

#### 4.1.1 Transaksionet me kartela në POS terminale

Nga të dhënat e prezantuara në figurën 10 shihet se qytetarët e Kosovës preferojnë të kryejnë pagesa me vlera më të vogla: 69 përqind e numrit të përgjithshëm të pagesave në POS terminale është në vlerë 0-20 Euro, ndërsa 31 përqind mbi 20 Euro.

Po ashtu, nga figura 10 vërehet se pagesat në POS terminale mbi 200 Euro janë në numër shumë të vogël, ato përbëjnë vetëm 1.3 përqind nga numri i përgjithshëm i pagesave të realizuara në POS gjatë vitit 2017.

Figura 10. Numri i pagesave me kartela në terminale POS




Burimi: BQK (2018)

#### 4.1.2 Transaksionet me kartela në ATM terminale

Në figurën 11 është paraqitur numri i tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2017, i ndarë sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave. Numri i tërheqjeve në terminale ATM në vlerë deri në 20 Euro përbën 32.4 përqind të numrit të përgjithshëm të tërheqjeve, tërheqjet në vlerë 21-50 Euro përbëjnë 21.3 përqind të numrit të përgjithshëm të tërheqjeve në ATM, ndërsa ato mbi 200 Euro përbëjnë 14.9 përqind të numrit të përgjithshëm të tërheqjeve në ATM gjatë vitit 2017.

Nga numri i përgjithshëm i tërheqjeve në ATM shihet se 65.6 përqind e numrit të transaksioneve janë realizuar nga meshkujt, ndërsa 34.4 përqind nga femrat.

Figura 11. Numri i tërheqjeve në ATM sipas vlerës



Burimi: BQK (2018)


#### 4.1.3 Transaksionet me kartela përmes internetit

Blerjet “online” me kartela viteve të fundit janë bërë shumë atraktive edhe për qytetarët e Kosovës, njëjtë sikur edhe për qytetarët e vendeve të tjera. Këto pagesa janë duke u shoqëruar me trende të shpejta zhvillimi. Ato kryesisht përdoren për blerje të mallrave apo shërbimeve, rezervime të hoteleve, pagesa të biletave për udhëtime etj.

Nga të dhënat e prezantuara në Figurën 12, vërejmë se blerjet “online” realizohen kryesisht në vlera të vogla: 70 përqind e blerjeve “online” janë në vlerë nga 0-20 Euro, ndërsa vetëm 5.5 përqind e tyre janë në vlerë mbi 200 Euro. Një nga arsytet që ka ndikuar në numrin e lartë të pagesave me vlera të vogla, pra deri në 20 euro, është se për mallrat deri në këto vlera nuk aplikohet tarifë doganore gjatë pranimit të mallit.

Po ashtu, nga figura shihet se blerjet në vlerë 0-20 Euro, 66 përqind janë kryer nga meshkujt, dhe 34 përqind nga femrat, ndërsa nga numri i përgjithshëm i blerjeve “online” 67.7 përqind e blerjeve janë kryer nga meshkujt, ndërsa 32.3 përqind nga femrat.

Figura 12. Numri i pagesave online sipas vlerës



Burimi: BQK (2018)


## 5. Transaksionet me kartelave sipas vend-ndodhjes së terminaleve të pagesave

Numri i terminaleve ATM dhe POS të cilët janë të instaluar në Kosovë janë kryesisht të koncentruar në qytetet më të mëdha, ku prin Prishtina me 36.02 përqind të numrit të terminaleve ATM dhe 43.3 përqind të numrit të terminaleve POS, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë mes qyteteve të tjera të Kosovës<sup>2</sup>. Arsytet e përqendrimit kaq të madh të terminaleve ATM dhe POS në Prishtinë janë të ndryshme si: numri i madh i banorëve që jetojnë në Prishtinë, numri i filialeve të bankave, bizneset që operojnë në këtë qytet, etj.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën 11 shihet se janë realizuar 50.5 përqind e transaksioneve me kartela në terminale ATM dhe POS të instaluara vetëm në qytetin e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër prej 49.5 përqind janë realizuara në terminalet e instaluara në 6 qytetet e tjera më të mëdha pas Prishtinës.

<sup>2</sup> Analizë mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Kosovë, Maj 2018, Prishtinë. <https://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemilPagesave/Analyze%20Tremujore.pdf>.

Figura 13. Numri i transaksioneve në terminale ATM dhe POS sipas qyteteve kryesore




Burimi: BQK (2018)

Njëjtë sikur numri i transaksioneve, po ashtu edhe vlera e tyre e realizuar në terminale ATM dhe POS është më e madhe për qytetin e Prishtinës, krahasuar me 6 qytetet e tjera më të mëdha në Kosovë.

Në Prishtinë është realizuar 44.8 përqind e vlerës së transaksioneve me kartela, ndërsa 55.2 përqind në 6 qytetet e tjera më të mëdha të Kosovës dhe që janë paraqitur në figurën 14.

Figura 14. Vlera e transaksioneve në terminale ATM dhe POS sipas qyteteve kryesore



Burimi: BQK (2018)

## 6. Konkluzionet dhe të gjeturat e analizës

### Përdorimi i kartelave

Pavarësisht se numri mesatar i transaksioneve me kartela në Kosovë për përdorues është më i vogël se mesatarja në vendet e Eurozonës, tregu i kartelave në vend vazhdon të zhvillohet me ritme të shpejta, duke u ofruar qytetarëve alternativa të lehta për kryerje të shërbimeve të pagesave. Nga të dhënat e paraqitura në këtë analizë mund të konstatohet se kartelat përbëjnë element të rëndësishëm në kuadër të instrumenteve të pagesave pa para të gatshme.

### Debit kartelat me pjesëmarrje më të madhe në treg

Kartelat e debitit mbeten më të shumta në numër krahasuar me ato të kreditit, dhe si rrjedhojë numri dhe vlera e transaksioneve të kryera me debit kartela është më e lartë krahasuar me kredit kartelat. Duke pasur parasysh numrin relativisht të lartë të kartelave në qarkullim, si dhe rrjetin e terminaleve ATM dhe POS, institucionet duhet të koncentrohen më shumë në rritjen e përdorimit të kartelave të cilat tanimë janë të shpërndara te qytetarët, por që përdorimi i tyre në terminale të pagesave mbetet i ulët.

### Shpeshësia e përdorimit

Inkurajues është fakti se qytetarët po i përdorin kartelat edhe për kryerjen e transaksioneve me vlera të vogla të cilat paraqesin pagesa të përditshme, që zakonisht janë në numër të madh. Kryerja e këtyre pagesave me anë të kartelave do të ndikojë në zvogëlimin e qarkullimit të parasë së gatshme duke zvogëluar shpenzimet operative të ndërlidhura me qarkullimin e tyre.

### Zhvillimi i fushatave edukative

Institucionet financiare në vend t'i kushtojnë rëndësi më të madhe zhvillimit të fushatave edukative për përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave.

### Vlerësimi i efikasitetit të fushatave edukative për pagesa me kartela

Krahas zhvillimit të fushatave edukative për përdorimin e instrumenteve elektronike për pagesa, institucionet financiare duhet të bëjnë vlerësimin e rezultateve të këtyre fushatave, duke analizuar dhe matur rezultatet e arritura gjatë fushatave të tilla.

### Ofrimi i tarifave më të ulëta

Institucionet financiare duhet të ofrojnë tarifa më të volitshme për qytetarët të cilët kryejnë pagesa me kartela, po ashtu edhe për kompanitë të cilat pranojnë kryerjen e pagesave



përmes kartelave. Në këtë mënyrë qytetarët dhe bizneset do të nxiten për përdorimin e kartelave për kryerje të pagesave.

## 7. Lista e tabelave dhe figurave

Tabela 1. Terminalet ATM.....	8
Tabela 2. Terminalet POS.....	9
Tabela 3. Llojet e kartelave.....	10
Tabela 4. Kartelat contactless.....	11
Figura 1. Shpërndarja e terminaleve ATM nëpër qytete.....	8
Figura 2. Shpërndarja e terminaleve POS nëpër qytete.....	9
Figura 3. Numri i kartelave sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësit të kartelës.....	11
Figura 4. Numri i pagesave me contact dhe contactless debit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).....	13
Figura 5. Vlera e pagesave me contact dhe contactless debit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).....	14
Figura 6. Numri i pagesave me contact dhe contactless kredit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).....	15
Figura 7. Vlera e pagesave me contact dhe contactless kredit kartela në terminale (sipas moshës dhe gjinisë së mbajtësve të kartelave për vitin 2017).....	16
Figura 8. Numri i pagesave online.....	17
Figura 9. Vlera e pagesave online (me kartela përmes internetit).....	18
Figura 10. Numri i pagesave me kartela në terminale POS.....	19
Figura 11. Numri i tërheqjeve në ATM sipas vlerës.....	20
Figura 12. Numri i pagesave online sipas vlerës.....	21
Figura 13. Numri i transaksioneve në terminale ATM dhe POS sipas qyteteve kryesore.....	22
Figura 14. Vlera e transaksioneve në terminale ATM dhe POS sipas qyteteve kryesore.....	22